RELACION TEKNIK ARKITEKTONIK

Objekti : "*RIKUALIFIKIMI I QENDRES SE GOLEMIT"*

Funksioni: HAPESIRA PUBLIKE

Zhvilluesi: BASHKIA KAVAJE.

Adresa e objektit: NJESIA ADMINISTRATIVE GOLEM , BASHKIA KAVAJE.



1. Vendndodhja

Zona ne te cilen parashikohet te nderhyet ndodhet ne njesine administrative Golem.

Golemi është një vendbanim dhe njësi administrative e Kavajes e vendosur në rrafshinat qendrore të rajonit të ultësirave perëndimore të Shqipërisë dhe një nga lokalitetet më të mëdha te qarkut e cila eshte edhe nyje e rendesishme per vizitorët e jashtëm qe frekuentojne plazhin .

Saktesisht pjesa ne te cilen do te kete nderhyrje ndodhet ne qender te kesaj njesie dhe aktualisht ne kete hapesire ndodhen godinat e vjetra te shtetit sic jane ish stallat.

2. Pershkrimi i situates ekzistuese

Hapesira momentalisht eshte e ndertuar. Kemi te bejme me objekte pjeserisht jo-funskionale, shembja e te cileve parashikohet si hapi i pare i zbatimit te ketij projkti.

Situata aktuale e godinave te vjetra eshte ne nje gjendje te rrenuar, dhe aktalisht eshte jashte perdorimit. Duke qene se keto objekte jane ne gjendje te degraduar dhe te pa-riparueshme dhe duke qene se njesise administrative Golem i mungon nje hapesire publike, keto godina jane planifikuar te prishen, per te krijuar nje hapesire qe u nevojitet banoreve si zone rekreative e gjelberuar.

3. Pershkrimi i konceptit te nderhyrjes urbane

Ky studim ka pasur si qellim rehabilitimin dhe rivitalizimin e kesaj hapesire duke e bere ate me te frekuentueshme dhe funksionale sipas kerkesave qe kjo zone mbart. Duke marre parasysh formen dhe pozicionimin ne lidhje me zonen perreth, te hapesires ne te cilen do te nderhyhet, eshte menduar nje shperndarje sa me e pershtatshme e zonave dhe funsioneve specifike. Ky koncept nderhyrje ka per qellim te ndihmoje kedo qe per arsye te ndryshme i afrohet kesaj zone.

Kjo zone paraqitet me kushte shume te mira per urbanizim te mëtejshëm me objekte te destinacioneve te ndryshme. Terreni i zonës është pjeserisht i rrafshet dhe mjaft i favorshëm per ndërtim i cili i jep një impakt zhvillimit urban te zones e cila është nje zone banimi me rezidenca dhe shërbime te ndryshme 3 – 4 kate.

Qëllimi kryesor i kësaj faze, nëpërmjet konsultimeve të vazhdueshme me investitoret dhe me zbatuesit e projektit, dhe duke pare tendencat e zhvillimeve te komunitetit lokal, mbetet përgatitja dhe paraqitja e planit të zhvillimit. Faza e hartimit duhet të përfshijë një analizë të thellë të çështjeve dhe të mundësive alternative, duke i shoqëroruar ato me argumentime të plota për politikat e propozuara nga specialistet urbane te njesise.

Me ndërtimin e infrastrukturës se rrugëve te kategorive kryesore dhe rrugeve terthore qe e lidhin këtë zone me disa lagje te tjera te zhvilluara urbane me tepër si rezidenca dhe ndertesa ekonomike, individuale dhe me elemente te banesave te qytetit dhe me nje pejsazh arkitektonik natyror mendojme te krijojme nje hapesire publike ne funksion te komunitetit. Me zhvillimin e deri tanishëm dhe duke pare zhvillimin e praktikave me te mira e te arrira deri me tani ne këto zona, ka lindur nevoja te ndalemi edhe tek cilësia e objekteve te cilat te trajtohen nga ana arkitektonike, volumetrike, raportet me ndërtesat përreth, rifiniturat, sipërfaqet e gjelbëruara, pejsazhi mjedisor, dhe pse jo te bashkohemi me vendet e zhvilluara te cilat po i kthejnë ndertimet e tyre me sipërfaqe te gjelberta edhe ne vertikalitet duke ruajtur biodiversitetin edhe ne taracat e ballkonet dhe mbi te gjitha te respektohen normativat ne fuqi dhe Rregullorja e urbanistikës.
Objeki qe do te rikualifikohet ne ketë zone është studjuar nga ana volumetrike duke respektuar distancat urbane si dhe lidhjen organike me pejsazhin arkitektonik ekzistues duke ju përshtatur qëllimit te shfrytëzimit te tij kryesisht ne funksion te sherbimit per qytetaret.
Ne zgjidhjen qe i është dhenë objektit janë patur parasysh kërkesat e banoreve, ne bazë te kondicioneve dhe normativave te Urbanistikës, konturi i krijuar nga kufijtë e pronave dhe rrethanat konkrete ne te cilat ndodhet zona.

4. Pershkrimi i projektit arkitektonik

Nderhyhet do te jene ne permiresimin e hapsires ekzistuese ku do te kete ne mase te konsiderueshme gjelberim si dhe zgjidhje funksionale te
pershtateshme per kerkesat e kohes nepermjet krijimit te hapesirave te nevojshme standarteve dhe normativave ne fuqi, te cilesise se sherbimit dhe interierit/eksterierit duke ofruar komoditetin dhe korrektesine.

Projekti parashikon realizimin e nje zone rekreative, me gjelberim, peme te larta e rrugica te ngushta, per te krijuar nje mjedis te qete, te fresket dhe relaksues per banoret e zones.

Shperdarja e rrugicve permes hapesires se gjelber behet ne menyre shume organike, duke iu permbajtur nje rrjedhe te caktuar linjash, te cilat here pas here nderthuren per te krijuar sheshe te vogla, me stola per te pushuar.



Koncepti perfshin disa pjese te shtruara me pllaka betony ne trotuare ndersa tjetra me beton te stampuar (te derdhur ne vend), te vazhdueshme te cilat nderthuren me njera tjetren per te krijuar disa xhepa gjelberimi ndermjet tyre. Per keto hapesirat eshte menduar nje shtrim i vecante per te treguar ndarjen ndermjet funksioneve qe do te kene, duke qene se njera do te funskionoje si shesh dhe tjetra si rrugice. Shtrimi i rrugices do te behet me derdhje betoni te stampuar, dhe funksioni i saj baze do te jete qarkullimi e do te perdoret per te shetitur perreth lulishtes. Ndersa hapesira tjeter e shtuar, sic te jep pershtypjen edhe nga forma e saj me e gjere, do te kete funsionin e nje sheshi per te pushuar ose lloje te ndryshme aktivitetesh rekreative qe mund te zhvillohen aty. Sheshi planifikohet te shtohet me beton te stampuar, per te bere keshtu diferencen nga rrugica me te cilen nderthuret ne disa pika.

Te gjithe zones i eshte nenshtruar nje mobilim urban i thjeshte dhe funksional, i perbere nga 200 stola prej druri dhe hekuri. Gjelberimi i perdorur eshte i shumellojshem duke filluar nga bari dekorues tek shkurret e uleta, nga pemet e larta e ato gjetherenese tek lulet shumengjyreshe.





Ky projekt do te konsistoje ne hapat e meposhtem:

Shembja e godinave te vjetra. Keto godina aktualisht ndodhen jashte cdo funksioni dhe gjendja e tyre eshte kosiderueshem te demtuara. Ato ndodhen ne hapesiren ne te cilen do te zbatohet projekti i lulishtes, ndaj shembja e kesaj godine do te jete hapi i pare per te filluar zbatimin.

Gjate zbatimit fillimisht do te behet skarifikimi i sheshit ekzistues, e me pas germimi ne forme kasonete sipas kuotave te projektit i trupit te rruges. Kasoneta do cilindrohet dhe do verifikohet nese ka ndonje zone problematike qe do trajtim te vecante. Me pas do te procedohet me shtresen e zhavorrit me ane te se ciles do realizohet edhe profilimi i rrugicave dhe shesheve si ne drejtim terthor ashtu edhe gjatesor. Per rrjedhoje trashesia e kesaj shtrese ne veper nuk do jete uniforme. . Gjate betonimit ti kushtohet kujdes, pjerrtesive terthore.

Kto elemente te nderthurur e bejne kete njesi administrative qe te kete nje impakt visiv terheqes per banoret e kesaj zone dhe turisteve te shumte qe kjo zone ka.

“RAPORTI I PROJEKTIMIT”

PER RRUGET

1-Qendra Golem

2-Synej-Bago-Karpen

FINAL

1. Hyrje

1.1. RRUGA EKZISTUESE

Projekti Fillon ne dalje te nenkalimit te Golemit, duke u shtrire ne pothuajse te gjitha rruget kryesore te Golemit, kjo rruge este e perbere nga 9 akse kryesore me nje gjatesi totale rreth 2km

1.2. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Klasifikimi i terrenit është variabël përgjatë rrugës duke qene midis terrenit kodrinor dhe terreneve urban.Për sa i përket parametrave gjeometrike si p.sh. rrezja horizontale vlera minimale është 175m per terrene fushore, dhe 85m per terrene gjysem urabn. Duke patur parasysh projektimin gjeometrik te rruges gjithashtu dhe mbeshtetur ne detyren e projektimit rruget do te permiresohet me nje gjeresi 5.5m plus 2m parking ne bulevardin kryesor te Golemit Bulevardi I Palmave duke ruajtur gjeresine 7.5 te rruges ekzistuese. Gjithahstu dhe rruget e tjera te kesaj qendre jane permiresuar por kryesisht duke ruajtur parametrat ekzistues te tyre.



Tipi 1



Tipi 2



Tipi 3

Standardet gjeometrike tregohen ne tabelën e mëposhtme:

Design Element	Unit	Flat	Rolling	Mountainous	Escarpment	Urban/ Semi-Urban
Design Speed	km/h	70 (D5=60)	60	30	30	50
Min. Stopping Sight Distance	m	110	85	55	55	55
Min. Passing Sight Distance	m	275	225	175	175	175
% Overtaking Opportunity*	%	0*	0*	0*	0*	0*
Min. Horizontal Curve Radius	m	175	125	85	85	85
Transition Curves Required		Yes	Yes	Yes	Yes	No
Max. Gradient (desirable)	%	4	5	7	7	7
Max. Gradient (absolute)	%	6	7	9	9	9
Minimum Gradient	%	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
Maximum Superelevation	%	7	7	7	7	4
Crest Vertical Curve	k	31	18	10	10	10
Sag Vertical Curve	k	25	18	12	12	12
Normal Crossfall (Paved)	%	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5
Shoulder Crossfall (Paved)	%	4	4	4	4	4
Normal and Shoulder Crossfall (Unpaved)	%	4	4	4	4	4
Right of Way	m	variable	variable	variable	variable	variable

Siç është diskutuar me perfituesin, qëllimi i përgjithshëm i projektuesit ishte te përmirësonte rrugën gjurmën ekzistuese te rrugës duke minimizuar shpronësimet dhe ndikimet e mundshme, dhe ne fakt janë propozuar rregullime te vogla te gjeometrisë horizontale dhe asaj vertikale. Për sa i përket gjeometrisë horizontale te rrugës shumica e kthesave ekzistuese janë konsideruar si "jashtë standardit" si dhe janë bere edhe disa përmirësime te aksit ne projekt me qellim qe te përmirësohet rruga ekzistuese qe është një vazhdimësi kthesash dhe me pak pjese te drejta.
Per sa i perket niveletes vertikale pjerresia gjatesore eshte pothuajse ne te njejten pjerresi me
rrugen ekzistuese. Kouta e projektit varion midis 0m dhe 30m .n.d.

2. STUDIMI TOPOGRAFIK

2.1 HYRJE

Kapitulli vijues përshkruan punën e bere për krijimin e një rrjeti mbështetës përte gjithe kontratën
Ky material përfshin te dhëna mbi metodat e projektimit, rregullimit, matjeve, rikompensimeve dhe metodat e llogaritjes dhe rezultatet finale te këtij rrjeti mbështetës.
Konsulenti yne përdori mjete GPS total stacion për te bere studimin topografik.
Procedura standarde e studimit qe u ndoq, konsiston ne vendosjen me pare te Bazës ne një pike referimi te rrjetit dhe me pas dy skuadra te veçanta do te fillojnë te punojnë ne te dy drejtimet. Te dhënat regjistrohen ne memorien e instrumentit dhe me pas shkarkohen çdo dite nëpërmjet programit për tu përpunuar. Nëpërmjet vlerësimit te pare te te dhënave ndonjë gabim i mundshme do te ri përsëriste studimin.
Te dhënat e terrenit do te shkarkohen nëpërmjet një programi te dedikuar.
Te dhënat e mbledhura ne terren do te përpunohenpër te gjeneruar Modelin Dixhita 3D te Terrenit duke përdorur te njëjtin sistem koordinativ te adoptuar për te përcaktuar shtrirjen e rrugës (Sistemi Koordinatave UTM Bazat Permanente ALBCORS). Argjinaturat e skarpateve dhe prerjet janë te paraqitura nëpërmjet shenjave konvencionale, dhe jepen gjithashtu lartësitë e sipërme dhe te poshtme. Tombinot ekzistuese urat dhe veprave te tjera janë gjithashtu te paraqitura.
Modeli dixhital i Terrenit jepet nëpërmjet formatit DWG si me poshtë:
Pike tre-dimensionale (x,y,z), ne një layer (programi) te vetme te quajtur "POINT"

Vijat e ndërprerjes (majat e prerjeve, majat e skarpateve, muret, vijat e kontureve etj.) ne layer-a te veçante.
Ky dokument është përdorurpër rregullimet finale te projektit dhe përfshin te gjithë informacionin e mëposhtëm si simbolet topografike, layer-at e ndryshëm, shpatullat e përqendruara ne shpate, rrethimet, etj.
Karakteristikat topografike janë regjistruar me te gjitha detajet. Këtopërfshijnë, por nuk janë te kufizuara vetëm ne, shtrimin e rrugës, shpatullat, mbushjet për trupin e rrugës, skarpatet, urat, strukturat e drenazhit, kanalet anësore, shtratit e rrjedhjeve, punimet për mbrojtjen e skarpateve, kanalet e vaditjes dhe strukturat e tyre, punimet për mbrojtjen nga përmbytjet, muret mbajtës, ndërtesa, shërbimet utilitare (p.sh. shtyllat elektrike, shtyllat e telefonisë, rrjetet e furnizimit me ujë, rrjetet e kanalizimeve, drenazhimi i ujërave te shiut, etj.) kryqëzimet me rrugët e tjera, trotuare, zonat me rrezikshmëri gjeologjike dhe gropa përshfrytëzim.
Gjithashtu regjistrohen te gjithëkufijtë e dukshëm te pronave (p.sh. muret, muret e parapërgatitur, rrethimet, kanalet etj.)

2.2 Matjet

Ne te gjitha BM-te, vëzhgimi me GPS është bere duke përdorur marres GPS me Frekuence Dyfishe (Dual Frequency).
Pas përpunimeve baze te llogaritjeve për përcaktimin e vertekseve, gabimet e rrjetit te mbyllur eliminohen nëpërmjet metodës se minimumit te katroreve kuadratik..
Rezultatet e llogaritjeve baze te te gjitha vëzhgimeve i bashkëngjiten si Aneks këtij raporti.
Ne kemi përdorur GPS TRIMBLE R6 me frekuence duale nga TRIMBLE për rilevimin dhe TGO GPS si program për llogaritjet e mëtejshme. Këta instrumente përfaqësojnë teknologjinë me te mire ne tregun e vendit.
Specifikimet teknike te tyre për vëzhgimin kinematike janë:
HORIZONTAL 10mm + 1ppm
VERTIKAL 10 – 15 mm + 1 ppm

Baze

Rover

Përpunimi i te dhënave është bere me Trimble Geomatics Office Software, për rregullimet e rrjetit dhe modulet baze te procesit.

2.3 TE DHENAT E PROJEKTIMIT TE GJEOMETRISE HORIZONTALE
Shih Shtojcën A
2.4 TE DHENAT E PROJEKTIMIT TE GJEOMETRISE VERTIKALE
Shih Shtojcën A

3. PROJEKTIMI HIDRAULIK DHE HIDROLOGJIK

3.1 TE PERGJITHSHME

3.1.1 Pershkrimi i Projektit

Ky studim eshte i fokusuar mbi strukturat e drenazhimit dhe vlersimit hidraulik te rruges Goleit si dhe Synje Bago Karpen, që të verifikojë nese eshte arritur siguria për rrugën dhe për përdoruesit në rastin e përmbytjeve të rënda. Kjo nënkupton vlerësimin e ekzistences se studimit te përmbytjeve, nga studimi hidrologjik dhe, me pas, te projektohen strukturat e drenazhit që mund të përballojnë shkarkimin e projektimit.
Studimi eshte bere ne perputhje me **"Manualin per Projektimin e Rrugeve Shqiptare te vitit 2015** dhe manuale te tjera te standardeve te projektimit te rrugeve.
3.1.2 Klima Klima e zones se projektit eshte tipike Mesdhetare dhe me shume kontinetale dhe malore ne lindje te rruges.
Rreshjet vjetore jane afersisht 1200 mm ne rreth 74 dite. Muajt Korrik, dhe Gusht dhe Shtator perfshijne rreth 13% te rreshjeve totale vjetore.
Temperaturat mesatare mujore dhe te dhenat e rreshjeve nga stacioni pluviometrik i Tiranes jane paraqitur ne tabelat e figurat e meposhtme.

Tabla 1 Rreshjet Mujore te Stacionit te Tirane

Muaji	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nen	Dhj	Vjetore
Precipitimi (mm)	120	140	100	140	140	70	30	10	40	120	150	130	1190
Precipitimimesatar	8	7	7	8	9	3	3	1	3	7	9	9	74

Figura 1 Grafiku i Reshjeve Mujore te Stacionit te Tiranes



Tabla 2 Temperaturat Mujore te Stacionit te Tiranes

Muaji		Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nen	Dhj	Vjetore
Mes Temp Larte	(°C)	11	12	13	18	22	27	31	32	27	22	16	13	21
Mes Temp Norm	(°C)	6	7	8	12	17	21	24	24	20	16	11	8	15
Mes Temp Ulet	(°C)	2	2	3	7	12	15	17	17	13	10	7	3	9

Figura 2 Grafiku i Temperaturave Mujore te Stacionit te Tiranes



Temperatura mesatare nuk i kalon 32$_0$C ne muajt Qershor, Korrik, Gusht dhe Shtator per rreth 50 dite. Gjithashtu minimumi i temepratures 0$_0$C ne muajt Dhjetor dhe Mars. Ne pjesen me te ngritur te rruges temperatura gjithashtu zbret ne 0$_0$C gjate peridhes se dimirit.

3.2 STRUKTURAT EKZISTUESE TE DRENAZHIMIT

Rruga ekzistuese ka nje sistem te pamjaftueshem dreanzhimi. E gjithe pjesa kodrinore nuk ka sistem drenazhimi, te gjithe ujrat siperfaqesore mblidhen ne siperfaqen e rruges dhe shakrkohen ne piken me te ulet. Shume pak ose te papershtateshme tombino rrethore gjenden ne rruge, neshumicen e rasteve keto struktura jane te pamjaftueshme per largimin e ujrave. E vetmja strukture drenazhimi (eshte nje kanal ne fillim te Bulevardit te Palmave ne Golem) rruget e tjera gjenden afer kanaleve kryesor kullimi gje qe per te cilat nuk kane nevoje nderhyrje te medh ame vepra arti.

3.3 HIDROLOGJIA

3.3.1 Te Dhenat Baze

3.3.1.1 Te dhënat kartografike

Per qellim te studimit, eshte e nevojshme te njihen kufinjte dhe karakteristikat e ujembledhesve qe
ndikojne ne rruge, qe perben dhe fazes e pare te projektimit hidrologjik per permbytjet. Per te identifikuar secilin ujembledhes te rruges u perdor shkalla 1:25.000. Kjo shkalle eshte detajuar mjaftueshem per te njohur cdo karakteristike te rendesishme morfologjike te ujembledhesave, dhe ne te njejten kohe ajo perafron nje pjese te terrenit qe eshte me gjeresi te mjaftueshme per te perfaqesuar te gjithe ujembledhesin.

3.3.1.2 Te dhenat mbi Rreshjet

Te dhenat baze per llogaritjen e fluksit te rreshjeve te shiut ne seksionet e verifikimit jane mbledhur nga rreshje shiu afatshkurtra per periudha te ndryshme te stacionit te Tiranes, te vena ne dispozicion nga Instituti i Hidrometeorologjise te Universitetit te Tiranes te pasqyruara ne tabelen e meposhtme.

Tabla 3 Te dhenat e reshjeve te shiut per frekuenca permbytjeve.

Intervali I perseritjeve	Lartesi (mm)/Kohezgjatja e rreshjeve te shiut				
(Vite)	10min	20 min	30 min	1ore	2ore
10	22	27	31	42	60
20	25	30	35	46	69
50	29	35	40	53	82
100	32	38	45	58	89

Shirat me kohezgjatje te shkurter dhe me intensitet te larte jane ngjarja kryesore e motit, dhe rreth
60% e precipitimit eshte perqendruar ne 20% te kohezgjatjes se ngjarjes. Kurba eshte e pavarur
nga variacioni i stuhise te intensitetit te rreshjeve ne zone, ajo mund te influencohet dhe karakterizohet duke prezantuar variacionin e intensitetit, pothuajse te kufizuar, morfologjine dhe
aranzhimin e fronteve te lagesht orografik.
Te dhenat e regjstruara ne stacionin e Tiranes jane, keshtu, te pershtatshme per t'u regjistruar ne
kete projektim per te percaktuar kurbat probabilitare te klimes si me poshte:

$$\mathbf{h = at^n}$$

ku:
- **h** = lartesia e shiut ne mm pergjate kohes "t";
- **t** = Kohezgjatja e renies ne ore;
- **a** = gjatesia renies se shiut per cdo 1 ore;
- **n** = pjerresia e vijes.

Duke nisur nga shirat e Tabeles 4, parametrat "**a**" dhe "**n**" te kurbave te intensitetit/kohezgjatjes per intervale te ndryshem perseritjeje jane percaktuar si me poshte

Tabla 4 Kurba e renies se shiut per intervale te ndryshem perserites

Intervali perserites	Parametrat			
Vite	a	n	r	Ekuacioni
10	43.19	0.407	0.987	$h = 43.19t^{0,407}$
20	48.6	0.41	0.978	$h = 48.60t^{0,410}$
50	56.7	0.417	0.97	$h = 56.70t^{0,4117}$
100	62.1	0.411	0.973	$h = 62.10^{t0,411}$

3.3.2 Intervali Mesatar i Rikthimit (IMR)

Projektimi i sistemit te drenazhimit perfshin percaktimin e magnitudes se rrjedhjes per te cilen do te projektohet cdo linje e ketij rrjeti. Rrjedhja e projektimit eshte percaktuar bazuar ne analizat statistikore (frekuenca) nga regjistrimet historike te rrjedhjeve te ujrave per vendet ku jane kryer matje dhe nga regjistrimet e rreshjeve dhe parametrat hidrologjik lidhur me vendet ku nuk jane kryer matje. Rrjedhja e projektimit eshte percaktuar duke bashkangjitur nje interval mesatar te rikthimit. Intervali mesatar i rikthimit percaktohet si intervali mesatar ne vite ndermjet ndodhjes se
nje rrjedhjeje me magnitude te caktuar dhe rrjedhjes me te madhe. Eshte mesatarja afatgjate e intervaleve ndermejt tejkalimit te njepasnjeshem te magnitudes se nje rrjedhjeje. Duke bashkangjitur nje interval mesatar rikthimi, marrim ne konsiderate nivelin e sigurise (standart) te kerkuar. Niveli i kerkuar i sigurise varet nga humbjet potenciale qe mund te ndodhin si rezultat i nje avarie (bashke stukturore dhe sherbimi) te nje elementi te sistemit te drenazhimit ose nje kombinimi te tyre. Pergjithesisht, sa me i gjate intervali

mesatar i rikthimit, aq me e madhe eshte magnituda e rrjedhjes dhe aq me i sigurte eshte niveli i mbrojtjes.

Tabla 5 Intervalet Mesatare te Projektimit per Permbytjet/Stuhite (vite) bazuar ne Kriterin Gjeometrik te Projektimit

	Siperfaqja e drenazhimit	Frekuenca e projektimit (Vite)
Kanalet anesore dhe te mesit te rruges		
- Kapaciteti		10
- Veshjet mbrojtese		2
Tombinot		
- Autostradat dhe Rruget kryesore		50 minimum
- Rruget Dytesore		25 minimum
- Rruget Lokale		5 to 10 minimum
Ura/Tombino		
- Shume te vogla	< 2.50	25
- Te vogla	< 2.50	50
- Mesatare	≥2.50 - < 25.00	100
- Te medha	< 2.500	100

Duke qene se keto rruge jane rruge lokale dhe sekondare periodat e perseritjes jane marre te barabarta me 10 vite per kanalet, 20 vjet per tombinot rrethore dhe katrore deri ne 2m hapesire, 50 vite per tombinot e medha dhe 100 vjet per urat.
Parameter tjeter qe perdoret per te percaktuar periodat e persertjes eshte dhe shtrirja e baseneve,
kështu:
- nga 0 ne 2.5 km^2 perioda e perseritjes 20 vjet;
- nga 2.5 ne 25 km^2 perioda e perseritjes50 vjet;
- mbi 25 km^2 perioda e perseritjes100 vjet

3.3.3 Vleresimi i shkarkimit te projektimit

Vleresimi i shkarkimit te projektimit llogaritet per aplikimin e Metodes Racionale. Kjo formule racionale vlereson vleren maksimale te prurjes ne cfaredo lloj vendndodhjeje te nje baseni ujembledhes si nje funksion te siperfaqes se drenazhimit, koeficientit te rrjedhjes dhe intensitetit te rreshjeve te shiut per nje kohezgjatje te barabarte me kohen e perqendrimit (koha qe i duhet ujit per te rrjedhur nga pika me e larget e basenit ne vendndodhjen qe po analizojme).
Kjo metode pergjithesisht rekomandohet per vleresimin e prurjes maksimale te projektimit gjate stuhise per siperfaqe me madhesi prej 1 km2. Edhe pse ajo ka hasur shpesh kritika per shkak te perafrimeve te thjeshta, asnje metode tjeter per projektimin e drenazheve nuk ka nje perdorim kaq te gjere. Gjithashtu ajo lejon kalibrimin e parametrave nga vezhgimet direkte ne terren.
Jepet me formulen e meposhteme;
Q = 0.002778 x I xKxC x S
ku :
- Q = vlera maksimale e prurjes, m^3/s
- I = intensiteti mesatar i rreshjeve të shiut për një kohëzgjatje të barabartë me kohën e përqendrimit "t_C", për një periudhë të përzgjedhur kthimi, **(mm/h)**
- **K** = Faktori i reduktimit te siperfaqes
- C = koefiçenti i rrjedhjes që përfaqëson një raport të rrjedhjes e të rreshjeve të shiut
- S = sipërfaqja e drenazhimit që kontribuon në vendndodhjen e projektuar, (ha)

Procesi i vleresimit te rrjedhjes se projektimit per nje ujembledhes nga te dhenat mbi rreshjet e
shiut perfshin hapat e metejshem:
- Percaktimi i baseneve ujembledhes
- Percaktimi i kohes se perqendrimit
- Vleresimi i reshjeve te shiut te projektimit
- Vleresimi i rrjedhjeve

3.3.3.1 Basenet ujembledhes, percaktimi i siperfaqes

Basenet ujembledhese jane percaktuar ne harta te shkalles 1:25.000 ku jane percaktuar gjithashtu te gjitha karakteristikat si kufinjte, siperfaqet, relievi, gjatesite e kanaleve dhe pjerresite. Me perdorimin e ekuacioneve qe do te jepen ne paragrafet vijues, karakteristikat e mesiperme do te perdoren per te percaktuar kohen e perqendrimit.
Dymbedhjete basen jane indetifikuar, pese per aksin 1, tre per aksin 2 dhe kater per aksin 3, karakteristikat fizike per secilin basen jane dhene ne shtojcen B.
Siperfaqja varion nga 0.04 deri ne 1.97 Km^2.

3.3.3.2 Koha e Perqendrimit

Per nje periode perseritje vendndodhje te dhene, intensiteti varet vetem nga kohezgjatja e reshjeve te shiut,t_d,, pasi parametrat e tjera jane konstante. Maksimumi i vleres prurjes per cfaredo periode perseritjeje shfaqet ne qofte se stuhia zgjat aq sa ajo arrin gjendjen e ekuilibrit. Nje stuhi me kohezgjatje me te madhe do te kete nje intensitet me te vogel dhe nje stuhi me e shkurter nuk do te arrije ekuilibrin. Kohezgjatja e rreshjeve te shiut qe jep vleren maksimale te prurjes per nje ujembledhes te dhene perkufizohet si koha e perqendrimit. Koha e përqëndrimit të reshjeve përcaktohet si periudha që i nevojitet ujit të zhvendoset nga pika më e lartë hidraulike e basenit ujëmbledhës në pikën e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut që kemi në shqyrtim. Nje pike
shiu brenda ujembledhesit mund ti bashkohet menyrave te ndryshme te rrjedhjes me shpejtesi te ndryshme levizjeje dhe keshtu me kohe te ndryshme levizjeje. Ne thelb, mund te perkufizohen tre lloj rrjedhjesh siperfaqesore qe jepen ne paragrafet vijues.

3.3.3.2.1 Koha e rrjedhjes mbitokesore (siperfaqesore)

Eshte hapi i pare i rruges se nje pike te shiut mbi toke, qe ne fillim. Pika nuk ndjek nje rruge specifike, por thjesht derdhet mbi toke per tu bashkuar me rrjedhjet e tjera. Nga evidentime empirike, shume formula jane raportuar ne literature bazuar ne karakteristikat morfologjike te ujembledhesit, sic jane gjatesia, pjerresia etj.
Formula e perdorur sipas SCS eshte:

$$Tc = \left(\frac{0.87L^3}{H}\right)^{0.385}$$

ku:
- *L* = rruga e rrjedhjes (km)
- *H* = diferenca e kuotave (m)
- Tc = e shprehur ne ore.

3.3.3.2.2 Rrjedhje e ceket e perqendruar

Pas maksimumi 100 metrash, rrjedhja siperfaqesore shnderrohet ne nje rrjedhje te cekte te perqendruar. Shpejtesia mesatare e kesaj rrjedhjeje eshte nje funksion i ujembledhesit, pjerresise dhe tipit te siperfaqes (kanalit). Nga Manuali i Drenazhimit, ekuacioni i meposhtem eshte perdorur per te percaktuar shpejtesine e rrjedhjes:

$$V \square 16.13(s)^{0.5}$$

ku:
- V = shpejtesia mesatare (m/s)
- *s* = pjerresia e linjes hidraulike (m/m)

3.3.3.2.3 Koha e Kanalit te Hapur

Kanalet e hapura jane supozuar te fillojne ku kanalet jane te dukshem ne fotografite ajrore ose ku linjat qe tregojne rrjedhje te perqendruara jane te dukshme ne hartat topografike. Ekuacioni i Maningut mund te perdoret edhe per vleresimin e shpejtesise mesatare te rrjedhjes dhe ne kete menyre kohen e levizjes ne kanal.

$$V = \chi\sqrt{Ri}$$

$$\chi = \frac{R^{\frac{1}{6}}}{n}$$

ku:
- V = shpejtesia e shprehur ne m/s
- R = rrezja hidraulike (m)
- i = pjerresia e kanalit (m/m)
- n = Koeficienti Maning.

3.3.3.3 Vleresimi i reshjeve te projektimit

Intensiteti i rreshjeve të shiut (i) është vlera mesatare e këtyre rreshjeve, mm/h, për një kohëzgjatje të barabartë me kohën e përqëndrimit për një periudhë të përzgjedhur kthimi. Qe ne momentin qe projektimi konsideron rruget lokale dhe sekondare, periodat e perseritjes jane marre te barabarta me 10 vite per kanalet, 20 vjet per tombinot rrethore dhe kuti deri ne 2m hapesire, 50 vite per tombinot e medha dhe 100 vjet per urat.

3.3.3.4 Vleresimi i rrjedhjes

3.3.3.4.1 Faktori i Reduktimit te Siperfaqes "K"

Pergjithesisht, per nje IMR te specifikuar dhe per nje kohezgjatje, thellesia mesatare e reshjeve te shiut mbi nje siperfaqe eshte me pak se thellesia e reshjeve ne nje pike. Raporti i mesatares se reshjeve te shiut per siperfaqe, per nje kohezgjatje te caktuar dhe IMR te reshjeve ne nje pike me te njejten kohezgjatje ku si IMR eshte quajtuar faktori i reduktimit siperfaqesor.

Faktoret e reduktimit te siperfaqes aplikohen per te projektuar vetem intensitetet e reshjeve ne nje pike, per te llogaritur faktin se nuk mund te ndodhe qe reshjet te kene te njejtin intensitet mbi te gjithe siperfaqen ku ndodh stuhia (principi i stuhise se projektimit pranon se stuhia e projektimit eshte e perqendruar mbi ujembledhes).
Formula mund te shprehet si:

$$K = 1 - 0.044A^{0.275}$$

ku:
- K = Faktori i Reduktimit te Siperfaqes
- A = Siperfaqja e basenit (km^2)

Ne tabelen e meposhtme jepen intensitetet e reshjeve te shiut per disa intervale kthimi per cdo
ujembledhes, me Faktorin e Reduktimit te Siperfaqes

3.3.3.4.2 Koeficienti i Rrjedhjes

Jo i gjithe volumi i rreshjeve shkakton rrejdhje. Nje pjese e madhe e reshjeve humbet nga filtrimi nentokesor duke mbushur boshlleqet. Volumi qe shkakton rrjedhje varet nga kushtet e lageshtise dhe karakteristikat morfologjike te ujembledhesit.
Jane percaktuar koeficientet vijues te rreshjeve te shiut "C":
- Asfalt dhe mbulesat 0.85
- Zona Residenciale, Zona me nje-familje 0.40
- Zona te pazhvilluara, toke natyrore argjilore 0.20

3.3.3.5 Vleresimi i shkarkimit

Ne tabelen vijuese llogaritja e pikut te shkarkimit per cdo ujembledhes eshte paraqitur per intervalin e kthimit 10, 20, 50 dhe 100 vjet.

Tabla 7 Shkarkimi per cdo ujembledhes

BASENI UJMBLEDHES				Koha Perq.	RESHJET – IMR (VITE)				PARAMETRAT HIDRAULIKE		HKARKIMET			
N°	Chainage		Area		IMR 10	IMR 10	IMR 10	IMR 10			ARI 10	ARI 20	ARI 50	ARI 100
	from km	*to km*		*m^3/s*	*m^3/s*	*m^3/s*	*m^3/s*	*mm/h*	*K*	*C*	*m^3/s*	*m^3/s*	*m^3/s*	*m^3/s*
AKSI 1														
1a	0+000	0+600	1.96	**0.39**	76	85	98	108	0.947	**0.20**	7.801	8.753	10.144	11.174
2a	0+600	1+075	8.75	**0.60**	58	66	76	84	0.920	**0.20**	26.162	29.394	34.170	37.540
3a	1+075	1+900	0.12	**0.09**	182	203	233	259	0.976	**0.20**	1.136	1.269	1.456	1.618
4a	1+900	2+550	0.04	**0.06**	240	268	306	341	0.982	**0.20**	0.530	0.592	0.676	0.754
5a	2+550	2+931	0.24	**0.38**	77	86	100	110	0.970	**0.20**	1.014	1.138	1.318	1.452
AKSI 2														
1b	0+000	0+350	0.37	**0.12**	153	171	196	218	0.966	**0.20**	3.060	3.422	3.933	4.363
2b	0+525	1+200	0.04	**0.04**	279	311	355	397	0.981	**0.20**	0.681	0.759	0.866	0.966
3b	1+200	2+175	1.16	**1.67**	32	36	42	46	0.954	**0.20**	1.955	2.203	2.580	2.817
AKSI 3														
1c	0+200	1+225	1.27	**0.71**	53	59	69	76	0.953	**0.20**	3.533	3.972	4.623	5.073
2c	1+225	2+175	0.75	**0.51**	64	72	84	92	0.959	**0.20**	2.563	2.878	3.342	3.675
3c	2+175	3+500	0.57	**0.24**	101	114	131	145	0.962	**0.20**	3.096	3.469	4.006	4.426
4c	3+500	4+725	0.61	**0.38**	76	86	99	109	0.962	**0.20**	2.493	2.797	3.241	3.571

3.3.3.6 Vlersimi i rrjedhjes per intersektimin me rrugen

Sasia e ujit qe do te drenazhohet per meter linear te rruges llogaritet nepermjet formules:

$$Q = \square(C * A) * i$$

ku :
- Q = shkarkimi ne m^3/s;
- C = koeficienti i rrjedhjes;
- A = brez me gjatesi 1 = 1m me nje gjeresi prej:
- l = 100m per toke natyrale, shume njesi te bashkuara (C = 0.20);
- l = 5.00 m hapesira e siperfaqes se rruges (Kr = 0.85) ;
- i = intensiteti i reshjeve te shiut per interval perseritjeje prej 10 vitesh dhe kohezgjatje te stuhise (t_c) 10 minuta (125 mm/h) per rrjedhjen e mbledhur nga ana e siperme e drenazhit dhe prej 5 minutash (188 mm/h) per ato te kunetave

Te dhenat njesi per shkarkimin jane
- 1.53 l/m per rrjedhje te siperme, duke mbledhur 200 mts gjersi baseni duke futur ketu edhe gjersine e rruges.
- 0.22 l/m per kuneta.

3.4 PROJEKTIMI HIDRAULIK

3.4.1 Proceduart e Projektimit Hidraulik

3.4.1.1 Projektimi Hidraulik i Tombinove

Kapaciteti hidraulik i nje tombinoje eshte llogaritur nga ekuacioni i energjise potenciale. Teorema e Bernulit pohon se prurja totale ne seksionin e fillimit eshte e barabarte me prurjen hidraulike te seksionit te poshtem plus humbjet e presionit te perqendruara ose te shperndara pergjate tombinos:

$$H_m = H_v + \square H$$

Ku:
- H_m = Prurja totale e rrjedhjes se siperme
- H_v = Prurja totale e rrjedhjes se poshteme
- $\square H$ = Humbjet midis seksioneve

Llogaritjet jane kryer duke konsideruar rrjedhjen kritike me shpejtesi rrjedhjeje te siperme $V_0 = 0$ dhe $V_0 > 0$

Duke zhvilluar ekuacionin e mesiperm, mund te shkruajme:

$$\square h = \square y + \square z = \frac{Q^2}{2gA^2}\left(Ke + L\frac{2g}{R^{4/3}K^2} + 1\right)$$

ku:

- **h**= diferenca ndermjet siperfaqes se ujit dhe nivelit te poshtem te kanalit, ne m ;
- **y**= diferenca ndermjet siperfaqes se ujit se siperme dhe te poshtme, ne m;
- **z**=difference diferenca ndermjet kuotes se poshtme te kanalit midis dy seksioneve, ne m

(z = iL) ;

- **Q**= prurja m^3/s ;
- **g**= nxitimi i renies se lire ne m/s^2 ;
- **A**= siperfaqe e lagies ne m^2;
- **R**= rrezja hidraulike in m;
- **K**= Koeficienti i ferkimit se ashpersise se Gauckler-Strickler, qe i korrespondon keficientit te ashpersise Manining **n**= **0,015**;
- **K_e=0,50** humbje prurjes se perqendruar ne grykederdhjen e tombinos per V=0 dhe **0,60** per V>0
- **L**= gjatesia e tombinos, m.

Tabla 9 Kapaciteti Hidraulik i Tombinove Rrethore

Gjeometria			PARAMETRAT HIDRAULIK										
Gryk.	Gjat,	Φ	Kusht. Punes	H (m)	h (m)	A	Perm i Lagur.	ydr. Rad	Pjerres ia	Δz	V	Shakri kimi	
n°	(m)	(m)		Sip.	Posht	(m^2)	(m)	(m)		(m)	(m/s)	(m^3/s)	
KAPACITETI I RRJEDHJES I LLOGARITUR PER LARTESI TE UJIT TE BARABARTE ME DIAMETRIN DHE V_0 = 0													
1	6.50	**0.60**	1	1.00	0.59	0.28	1.88	0.15	0.005	0.08	2.40	0.676	**h_w= Φ + 0.40**
1	8.00	**0.80**	1	1.20	0.71	0.47	2.47	0.19	0.005	0.08	2.63	1.235	**h_w= Φ + 0.40**
1	6.50	**1.00**	1	1.40	0.82	0.69	3.04	0.23	0.005	0.08	2.84	1.967	**h_w= Φ + 0.40**
1	6.50	**1.50**	1	1.90	1.12	1.41	4.43	0.32	0.005	0.03	3.31	4.676	**h_w= Φ + 0.40**

* 1) Kushte pune me shpejtesi hyrese $V_0 = 0$

* 2) Kushte pune me shpejtesi hyrese $V_0 > 0$

Ke=0,50 shkarkim i perqendruar ne brendesi te tombinos per V=0 dhe 0,60 per V>0

4. Raporti Projektimit pert Aksin Bago

- ***Gjatesia 2484***, do te kemi Φ1000 tombino rrethore me gjatesi prej 8.0m.



5.1 STUDIMI I DHERAVE DHE MATERIALEVE

5.2 HYRJE

Raporti mbi dherat dhe materialet prezanton metadat qe jane perdorur per te kryer detyrat e ngarkuara, sic jane percaktimi i llojit tokes, shtresave ekzistuese dhe studimet e matreilave te ndertimit te realizuara si pjese e projektit te detajuar per rehabilitmin e rruges te brendshme te Golemit, si dhe SYNEJ-KARPEN (. Ai trajton karakteristikat e pergjithshme te gjurmes se rruges ne lidhje me identifikimin e tipit, llojit dhe karakteristikave te dherave dhe formacioneve gjeologjike, percaktimi i materialeve te ndertimit, studimi i themelit te urave dhe pergjithesisht studime te pergjithshme gjeoteknike te nevojshme per te karakterizuar dherat dhe materialet pergjate rruges.

Rezultatet e studimeve gjeoteknike i jane bashkangjitur te dhenave mbi klimen dhe karakteristikave te tjera te rruges per te pasur nje projektim te sigurte dhe ekonomik te shtesave te rruges, te cilet do te jene pjese e ketij raporti.

Prandaj objektivi i ketij studimi gjeoteknik eshte te percaktoje dhe optimizoje rehabilitimin e shtrimit te rruges duke marre parasysh gjendjen aktuale te rruges dhe materialet e ndertimit ne dispozicion.

5.3 GJEOLOGJIA DHE GJEOMORFOLOGJIA

Shqiperia shtrihet teresisht ne brezin Orogjenik Alpin, brezi i shkembinjve i deformuar dhe i ngritur nga kushtet qe formuan Alpet Europiane. Ne Shqiperi, brezi perfshin sedimete Paleozoike dhe shkembinj metamorfike, shkembinj vullkanik dhe plutonik kryesisht te eres Mesizoike; dhe sekuenca te dendura te shkembinjve me te rinj sedimentare. Pjesa Veri-Lindore e brezit eshte me perspektive per minerale, si kromi, zinku, ari dhe metale te grupit te platinit. Pjesa jug-perendimore e brezit eshte me perspektive per rera bituminoze dhe gaz.

Pjesa veriore dhe lindore te brezit Orogjenik Alpin ne Shqiperi perfshin perhapjen e sekuencave ofiolite. Ofiolitet e Shqiperise perfaqesojne nje shtrese 4-8 km te trashe te kores oqeanike e cila u fut ne dhe mbi koren fqinje kontinentale gjate nje faze perplasjeje te Orogjeneve Alpine. Keto ofiolite jane vendosur pergjate Jurasikut te vonshem dhe Kratesikut.

Ofiolitet jane nje sekuence e shkembinjve qe perfaqesojne pllaken oqeanike dhe mantelin e siper qe tani i mbivendoset shkembinjve te Orogjeneve pre-Alpin kontinental te Europes.

Ofiolitet shqipetare formojne dy breza te harkuar veri-jug:

- Brezi i Ofioliteve Lindore eshte 20-30 km i gjere dhe ndodhet afer me kufirin lindor te Shqiperise, duke u shtrire ne jug ne Maqedoni dhe ne veri-lindje ne Kosove, ne nje distanca prej 150 km. Sekuenca e ketij brezi eshte midis 12 dhe 14 km i trashe, dhe perfshin pothuaj nje sekuence te plote ofiolite.

- Brezi i Ofioliteve Perendimor eshte shume me pak i gjere se ai Lindor. Ai shtrihet nga kufiri me Greqine deri ne veri te Shqiperise dhe kufirin me Kosoven, ne nje distanca prej rreth 200 km. Gjeresia lindje-perendim e ketij brezi varion nga 10 deri ne 15 km. Sekuenca ofiolitike e brezit Perendimor eshte me pak e plote se ai Lindor dhe eshte me pak se 4 km e trashe.

Nga pikepamja, Shqiperia i perket sistemit te Dinarideve (s.l.). Ky sistem mbulon te gjithe pjesen e bregut lindor te detit Adriatik (dhe pjeserisht te detit Jon). Ai eshte dega me jugore e brezit alpin. Megjithese mendohet si pjese e sturktures se Dinarideve, vargjet malore ne jug te linjes Shkoder- Peje quhen Helenide (shih figuren I).

Carja tektonike Shkder-Peje ndan Dinaritet me Hellenidet, gjithashtu luan nje rol te rendesishem në modelin gjeologjik të Veriu te Shqiperise



Zona kryesore strukturale te Shqiperise jane paraqitur ne Figuren I

Gjeologjia dhe tektonika e Shqiperise perfaqesohet kryesisht nga zona Hellenifike gjate

formimit te zinave strukturialeve duke formuar (basene).

Gjeologjia e rruges Kodovjat Kukur me nje gjatesi prej 11.3km eshte kryeshit e karakterizuar nga terrene flyshore te lidhura me toka argjilore. Depozistimet kontinetale jane te perfaqesuara nga depozitime alluviale (Oligocene – Plestocene).

Zona topografike e trupit te rruges eshte e perfaqesuar nga zone kodrinore – malore, lartesia e kuotes se projektit shkon nga 250m deri ne 500m mbi nivelin e detit.

5.4 INVEST GIMET NE TERREN

5.5 Te Pergjithshme

Studimet gjeologjike per rehabilitimin e rruges Golemit, si dhe SYNEJ-KARPEN u mbajte midis Mars 2020. Jane permbushur detyrat vijuese te studimit.

- Vlersimi vizual.
- Shpime studimore.
- Vlersimi mbi materialet.

Objektivi i ketij studimi gjeoteknik eshte te percaktoje dhe optimizoje rehabilitimin e shtrimit te rruges duke konsideruar gjendjen aktuale te rruges dhe materialet e ndertimit ne dispozicion.

Eshte bere nje studim i detajuar i shtresave te rruges per te patur mundesine e:

- Perfshirja e shtresave ekzistuese dhe shtresat e reja te rruges;
- Riperpunimi i materialeve te shtresave ekzistuese per shtresat e meposhtme te rruges\
- Konsiderimi i rikonstruksionit ku shtresat ekzistuese jane te shkaterruara

5.3.2 Pershkrimi I Shtresave Rrugore

Studimi i shtresave ekzistuese rrugore u krye ne menyre qe te krijohet nje ide mbi gjendjen ekzistuese te siperfaqes rrugore, mbi prishjet e strukturave rruogre dhe per te identifikuar shkaqet e ndodhjes se ketyre prishjeve ne menyre qe te ndermerren masa permiresuese ne projektimin e ri te shtresave te rruges dhe ne fazenen e ndertimit te tyre. Pervec ketyre, ky investogim u be ne menyre qe te identifikoheshin zonat ku nenshtresa eshte e dobet dhe zonat ku cilesia dhe kapaciteti i sjelljes se materialit te shtresave nuk eshte ajo e duhura.

Persa i perket shtresave rrugore keto jane rruge e shtruar me asfalto beton me pjesen me ne gjendje shume te keqe dhe e deformuar dhe me carje te asfaltit.

5.3.3 Shpimet (gropat) Studimore

Gropa studimore jane bere pergjate rruges per te percaktuar strukturen e shtresave ekzistuese te rruges dhe per te vleresuar cilesine e materialeve ne menyre qe te riperdoren ne forcimin, rehabilitimin dhe rikonstruksionin e rruges

Gropat jane hapur cdo 1000 m duke iu referuar Termave te References. Bazuar ne inspektiminvizual, vendndodhja e gropave eshte vendosur ne ato pjese ku ishte kryer dhe pershkrimi dhe mbledhja e mostrave.

Per secilen nga gropat eshte regjistruar informacioni i

meposhtem:

1 trashesia e shtresave;

2 lloji i materialit te perdorur dhe prejardhja e mundshme e tij;

3 cilesia e shtreses bituminoze;

4 ndonje nderhyrje qe eshte kryer ne shtresat ekzistuese, si rimbushje ose ndryshim etj.

Shpimet studimore reflektojne gjendjen ekzistuese te rruges. Duke kombinuar te dhenat e gropava studimore (trashesine dhe cilesine) dhe vleresimi vizual, nuk kemi ndonje diference qe ndryshon shume pergjate gjithe trupit te rruges. Strukturat e indetifikuara jane si meposhte.

Rruga eshte e asfaltuar shtresatce ciles jane asfaltobetoni (me tarshesi mesatare 5.3cm), dhe nje shtrese cakulli dhe zhavorri (me trashesi mesatare 18.2cm), e cila qendron mbi rere ose agjile (skarapata ose toke natyrale). Trashesia totale e shresave eshte 23.5cm.

Stratigrafia e shpimeve studimore jepet si me poshte

TRIAL PITS STRATIGRAPHIES

.

5.3.2 Bazamentet dhe rezulatatet e provave laboratorike te shtresave ekzistuese.

Bazuar ne rezultatet e prova te shpimit, vendet e meposhteme jane indetifikuar si

perfaqesues te te gjithe cilesise se **nenbazes**; per rrugen Golemit, si dhe SYNEJ-BAGO **:Golem** 0+200 RHS dhe 0+600 RHS per **Synej**, 0+400 RHS dhe 2+000 RHS per **Bago** 2 dhe 0+200 RHS, 1+200 LHS, . Ne keto vendodhje u morren monstrat dhe u kryen provat, rezultatet e te cilave jepen ne tabelen e meposhteme.

Aksi	**Aksi1**		**Aksi2**		**Aksi 3**	
Kilomertazhi	**0+200**	**0+600**	**0+400**	**2+000**	**0+200**	**1+200**
Shtresa	**Nenbaza**					
Kalon. 50 mm	100	100	100	100	100	100
Kalon. 20 mm	99.2	99.7	99.1	90.1	91.6	99.4
Kalon. 10 mm	98.3	97.8	97.2	86.3	88.7	98.5
Kalon. 4.75 mm	96.6	95.8	95.0	92.8	85.0	97.0
Kalon 2.36 mm	95.6	94.2	93.2	75.0	79.4	95.9
Kalon. 1.18 mm	94.5	93.4	91.8	67.5	72.7	94.7
Kalon. 0.6 mm	92.9	91.1	89.7	60.9	66.0	93.2
Kalon. 0.3 mm	87.3	84.4	83.3	51.4	57.8	87.5
Kalon. 0.15 mm	75.2	70.2	70.9	40.6	47.2	75.6
Kalon. 0.075 mm	65.5	59.7	55.5	34.3	41.9	66.2
Kufiri i lengezimit	27.0	31.8	32.9	39.8	41.1	37.9
Treguesi i plasticitetit	10.5	13.7	15.0	13.5	20.1	18.5
